

	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOŠOVA <b>KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË</b> THE MUNICIPALITY SUHAREKË SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA	
---	--	---

Në pajtim me nenin 7, 8 dhe 9 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve Nr- 02 / L – 37, të nenit 9 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr- 03/L - 040 dhe të nenit 13 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datë 11.11.2008 Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.12.2008 miratoi:

**RR E G U L L O R E N P Ë R**  
**P Ë R D O R I M I N E G J U H Ë V E**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Qëllimi**

**Neni 1**

Kjo Rregullore ka për qëllim që të rregullojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në pajtim me dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L – 37, në punën e organeve komunale, institucionet arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike komunale, që qeverisen nga Komuna.

**Neni 2**

Gjuha shqipe dhe gjuha serbe, si gjuhë zyrtare në Kosovë, janë të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha organet e administratës komunale, institucionet arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjet publike të Komunës së Suharekës.

**II. PËRDORIMI I GJUHËVE**

**Përdorimi i gjuhëve në takime zyrtare, në tubime publike, në mbledhje të Kuvendit të Komunës**

**Neni 3**

- 3.1 Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takimet me qytetarë, në punën e organeve të administratës, në kolegiumin e drejtoreve, në komitetet e përhershme dhe në komitetet tjera, si dhe në mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
- 3.2 Sektori për punë të përgjithshme administrative në Drejtori të Administratës, do të mundësojë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kjo kërkohet për takimet zyrtare, takimet publike, takimet e komiteteve dhe takimeve të tjera të organizuara nga Komuna;
- 3.3 Prosesverbalet nga mbledhjet, e kuvendit dhe komiteteteve, mbahen në gjuhët zyrtare.
- 3.4 Statuti i Komunës, Rregullorja e punës së Kuvendit, rregulloret komunale dhe vendimet që miratohen në Kuvendin e Komunës, shtypen në të dy gjuhët: në gjuhën shqipe dhe serbe.

## Përdorimi i gjuhëve nga individët, institucionet, shoqëritë tregtare, organizatat etj

### Neni 4

- 4.1 Secili person i cili i drejtohet Organit të Komunës ,institucionit arsimor ,shëndetësor apo ndërmarrjes publike komunale, e ka të drejtën e përdorimit të gjuhës së tij , në të shkruar dhe në të folur.
- 4.2 Nacioni “gjuhë e palës”, ka kuptimin e gjuhës në të cilën pala fillimisht i është drejtuar Komunës.

### Neni 5

Komunikimi me komunat tjera të Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës, shoqëritë tregtare, organet dhe organizatat tjera mund të bëhen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

### 3. Përdorimi i gjuhëve në emërtimet zyrtare dhe shenjat zyrtare

### Neni 6

- 6.1 Emrat zyrtarë, të organeve komunale, të institucioneve arsimore , shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike të Komunës së Suharekës, janë të shkruara në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë.
- 6.2 Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të lagjeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, duhet të jenë të shkruara në të dy gjuhjet: në gjuhën shqipe dhe serbe.

## III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 7

Kjo Rregullore mund të ndryshohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

### Neni 8

Në rast të mospajtimeve mes dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve, do të mbizoterojnë dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

### Neni 9

Pas miratimit në Kuvendin komunal, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale.

## KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

01-Nr- 8853  
Më datë 31.12.2008



Kryesuesi i Kuvendit

Rexhep Kuçi